

L I G J

Nr. 8987, date 24.12.2002

PER KRIJIMIN E KUSHTEVE LEHTESUESE PER NDERTIMIN E BURIMEVE TE REJA TE PRODHIMIT TE ENERGIJISE ELEKTRIKE

Ne mbështetje te neneve 78 pika 1, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit te Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve lehtësuese, deri ne liberalizimin e plote te çmimit te energjisë elektrike, për çdo person juridik vendas dhe te huaj, qe do te ndërtojë burime te prodhimit te energjisë elektrike.

Neni 2

Çdo person juridik vendas dhe i huaj, qe do te ndërtojë burime te prodhimit te energjisë elektrike me fuqi te instaluar jo me pak se 5 MW për burim, qe përdorin lende djegëse te lëngëta ose te ngurta dhe pa kufizim për burimet e tjera te rinovueshme te prodhimit, përjashtohet nga taksat doganore për makineritë dhe pajisjet, qe bëjnë pjese ne objektin e prodhimit te energjisë elektrike.

Neni 3

Çdo personi juridik vendas dhe i huaj, qe ndërton burime te prodhimit te energjisë elektrike, sipas përcaktimeve te nenit 2 te këtij ligji, i rimburohet kundervlefta e paguar për taksat doganore dhe akcizat e lendeve djegëse te lëngëta ose te ngurta te përdorura për sasinë e energjisë se shitur, duke marre ne konsiderate konsumin specifik te teknologjisë se zbatuar .

Rimbursimi i taksës doganore dhe akcizës se lendeve djegëse, te përdorura për prodhimin e energjisë elektrike, behet çdo 45 dite.

Neni 4

Enti Rregullator i Sektorit te Energjisë Elektrike miraton marrëveshjen e shitjes se energjisë elektrike ndërmjet personave juridike vendas dhe te huaj, qe do te stimulohen për prodhimin e energjisë

elektrike, sipas këtij ligji, me Kompaninë Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) ose konsumatorët e kualifikuar.

Neni 5

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e neneve 2 dhe 3 të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Shpallur me dekretin nr. 3664, datë 14.1. 2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

Copyright 2009 - www.ligjet.org